

NJOFTIM PËR TENDER

I nderuar Partner,

Agjencia Austriake për Arsim dhe Ndërkombëtarizim (OeAD), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar jofitimprurëse e qeverisë federale austriake. Aktiviteti i saj shtrihet në Austri, Evropë dhe në nivel ndërkombëtar. OeAD ka këshilluar, mbështetur dhe ndërlidhur njerëzit dhe institucionet në fushat e arsimit, shkencës, dhe kulturës nëpërmjet programeve të saj, për 60 vjet.

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit e Sportit dhe institucionet e tyre të varësisë, Zyra Rajonale e OeAD në Tiranë, zbaton projekte në fushën e arsimit dhe formimin profesional, përmirësimit të cilësisë në shkolla, mësimdhënies dhe të nxënies bazuar në kompetenca.

Në kuadër të projektit **“BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM” I QYTETIT TË VJENËS, “AL-VET – Quality for All”, Arsim profesional me cilësi të lartë dhe gjithëpërfshirje sociale në Shqipëri**, OeAD, shpall procedurën e prokurimit me objekt: *“Blerje dhe instalim të pajisjeve për Bar-in dhe Kuzhinë në Shkollën Profesionale të Hoteleri-Turizmit në Tiranë dhe Shkollën Profesionale Antoni Athanas në Sarandë”* me numër reference 9/2023, dhe fond limit 29,000 (njëzet e nëntë mijë) Euro, përfshirë TVSH. Për këtë procedurë do të zbatohet, për sa është e mundur, legjislacioni shqiptar për prokurimin publik.

Ftohen të gjithë subjektet tregtare të interesuara të shprehin interesin e tyre për pjesëmarrje në këtë procedurë tenderimi brenda datës **7 Dhjetor 2023 ora 16:00**. Afati maksimal për dorëzimin e ofertës është data **19 Dhjetor 2023 ora 12:00**.

Të interesuarit mund të shprehin interesin e të kërkojnë dokumentacionin e tenderit me anë të një mesazhi elektronik në adresën Elona.Daci@oead.at.

Oferta financiare së bashku me dokumentacionin e kërkuar duhet të dërgohen me zarf të mbyllur, në adresën postare:

Ambasada Austriake (OeAD) Kutia Postare 1421, 1001, Tiranë, Shqipëri